



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2024:116731
Datë: 01.11.2024
Numri i dokumentit: 06384921

PML.nr.677/2024

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët Afrim Shala, kryetar i kolegjit, Agim Maliqi dhe Mejreme Memaj, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtoren profesionale Qefsere Berisha, në çështjen penale ndaj të pandehurve M. M. dhe S. S., për shkak të dyshimit të bazuar se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, parashikuar me nenin 267, paragrafi 2 lidhur me nenin 275, paragrafi 1, pika 1.9 dhe nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të të pandehurve, të paraqitura kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Krimeve të Rënda, Ppr.nr.36/2024 të datës 19.09.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PN.1.nr.985/2024 të datës 01.10.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 31.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të të pandehurve M. M. dhe S. S., të paraqitura kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Krimeve të Rënda, Ppr.nr.36/2024 të datës 19.09.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PN.1.nr.985/2024 të datës 01.10.2024.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktvendimin Ppr.nr.36/2024 të datës 19.09.2024, të pandehurve M. M., N. U., S. S. dhe N. K., për shkak të dyshimit të bazuar se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, parashikuar me nenin 267, paragrafi 2 lidhur me nenin 275, paragrafi 1, pika 1.9 dhe nenin 31 të KPRK, ua ka vazhduar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej dy (2) muajve, duke ua llogaritur nga data 20.09.2024 deri me datën 20.11.2024. masa e paraburgimit iu është vazhduar konform dispozitës së nenit 188, paragrafi 1. lidhur me nenin 184, paragrafi 1. nën-paragrafi 1.1. dhe 1.2. pika 1.2.1, 1.2.2. dhe 1.2.3. të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PN.1.nr.985/2024 të datës 01.10.2024, i ka refuzuar ankesat e mbrojtësve të të pandehurve si të pabazuara dhe e ka vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë kanë ushtruar:

- mbrojtësi i të pandehurit M. M. avokati Xhemajl Çelaj, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së kodit penal dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale ku shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit, me propozim Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si të bazuar dhe të konstatojnë të ndryshojë aktvendimet e kundërshtuara ashtu që të pandehurit t'ia caktojë ndonjë masë tjetër alternative ose t'i anulojë dhe çështjen ta kthejë në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë, dhe

- mbrojtësi i të pandehurit S. S. avokati Behar Avdyli, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së kodit penal dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale ku shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit, me propozim Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si të bazuar dhe të konstatojnë të ndryshojë aktvendimet e kundërshtuara ashtu që të pandehurit t'ia caktojë ndonjë masë tjetër alternative ose t'i anulojë dhe çështjen ta kthejë në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Kryeprokurori i Shtetit të Kosovës, me parashtrësën KMLP.III.nr.284/2024 e datës 30.10.2024, ka propozuar që kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, shqyrtoi shkresat e kësaj çështje juridiko-penale dhe pas vlerësimit të pretendimeve gjeti se:

- kërkesat janë të pabazuara.

Mbrojtësit e të pandehurve në kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë, të cilat janë identike, theksojnë se aktvendimet e kundërshtuara përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të

procedurës penale, ngase të pandehurve paraburgimi u është vazhduar me argumentet lidhur me veprimet e tyre në dyshimin e kryerjes së veprës penale, derisa të pandehurit kanë qenë bashkëpunues dhe i kanë ndihmuar organet kompetente për t'i vërtetuar të gjitha faktet dhe veprimet e tyre, kanë treguar rrjedhën dhe rolin e tyre lidhur me çështjen. Aktvendimet e kundërshtuara nuk kanë arsyetim lidhur me dyshimin e bazuar, veprimet e kryerjes, rrethanat, peshën e veprës penale, dhe se me gjetjen e tyre në liri ekziston rreziku se do të mund të ndikojnë në rrjedhën normale të procedurës penale. Të pandehurit kanë gjendje të rënduar shëndetësore, i pandehuri M. M. vuan nga kanceri malinj, ka nevojë për ushqime të veçanta e që në paraburgim nuk plotësohen këto kushte. Kërkesës i ka bashkangjitur dokumentacion mjekësor, ndërsa i pandehuri S. S., nuk është në gjendje të mirë shëndetësore dhe emocionale dhe ka nevojë për asistencë psikologjike për ta përballuar situatën në të cilën ndodhet.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mësipërme janë të pabazuara, ngase nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, nga kallëzimi penal me numër të rastit R-2024-XI-DKKO-HTN-NJHHK-7 të datës 20.04.2024, aktvendimit për fillimin e hetimeve, procesverbali për kontroll dhe sekuestrim i datës 20.04.2024, procesverbale e marrjes në pyetje të të dyshuarve, kërkesa për masa të fshehta – hetim i fshehtë dhe shtija dhe blerja e simuluar e artikujve, shërbimeve apo sendeve datës 20.04.2024, fakti se të pandehurit janë kapur në flagrancë nga ana e policisë në posedim të substancës narkotike, informacionet personale dhe shkresave tjera në lëndë, rezultojnë dyshimi i bazuar se të pandehurit dyshohet se kanë kryer veprën penale për të cilën pandehen, kurse a do të argumentohen këto fakte e prova do të vlerësohet në fazat e ardhme të procedurës penale, me çka janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 184, paragrafi 1. nën-paragrafi 1.1. e 1.2. të KPP-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mësipërme janë të pabazuara, ngase ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 184, paragrafi 1. nën-paragrafi 1.1. e 1.2., pika 1.2.1. të KPP-së, ngase me lëshimin e të pandehurve në liri ekziston rreziku i fshehjes apo arratisjes me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale duke pasur parasysh rrezikshmërinë dhe dënueshmërinë e veprës penale, e në këtë mënyrë do ta pamundësojnë zhvillimin e rregullt të procedurës penale.

Kjo gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 184, paragrafi 1. nën-paragrafi 1.1. e 1.2., pika 1.2.2 të KPP-së, ngase me lëshimin e të pandehurve në liri ekziston rreziku i ndikimit në dëshmitarët apo bashkëkryesit me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale, e në këtë mënyrë do ta pamundësojnë zhvillimin e rregullt të procedurës penale.

Po ashtu, kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e masës së paraburgimit konform nenit 184, paragrafi 1. nën-paragrafi 1.2. pika 1.2.3 të KPP-së, duke pasur parasysh peshën e veprës penale, mënyrën dhe rrethanat në të cilat dyshohet se është kryer vepra penale, karakteristikat personale të të pandehurve, duke pasur parasysh sasinë e narkotikut, në peshë prej 50 kg e 600 gr., faktin se dy të pandehur kanë të kaluar kriminale me vepra penale nga kapitulli i veprave penale të narkotikut, janë rrethana të cilat tregojnë se po të gjenden të pandehurit në

liri ekziston rreziku se do të mund të përsërisin veprën penale të natyrës së njëjtë apo të ngjashme, andaj vazhdimi i paraburgimit është i arsyeshëm për rrjedhën normale të procedurës penale.

Sa i përket raporteve mjekësore të bashkangjitura në kërkesë, këto raporte nuk përmbajnë rekomandime apo konstatime të cilat kishin mundur të jenë indicie e fortë për gjykatën se për shkak të gjendjes shëndetësore të të pandehurit duhet menjëherë të lirohet nga paraburgimi, po ashtu në institucionin ku gjenden të pandehurit ka mjek të cilët kujdesen për gjendjen shëndetësore dhe se me rekomandimin e tyre të pandehurit mund të hospitalizohen apo dërgohen për mjekim jashtë institucionit ku ndodhen.

Andaj nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje të dispozitave të procedurës penale, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, të cilat si të drejta i pranon edhe kjo Gjykatë, ndërsa masat tjera alternative, sipas propozimit të mbrojtësve të të pandehurve nuk janë masa adekuate për fazën në të cilën ndodhet procedura penale.

Nga sa u parashtrua më lartë dhe në kuptim të nenit 437, të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.677/2024, me datë 31.10.2024

Bashkëpunëtorja profesionale
Qefsere Berisha

Kryetari i kolegjit,
Afrim Shala